

A surreal landscape where giant ice cream cones are scattered across a desert of sand dunes. The scene is bathed in a warm, golden light, suggesting a sunset or sunrise. In the foreground, a small figure of a person stands next to a tall wooden ladder leaning against the base of a massive ice cream cone. The cones vary in size and are topped with different textures, some appearing to have multiple scoops. The background shows rolling sand dunes under a clear, bright sky.

HISTORIA E AKULORES

HISTORIA E AKULLORES

Albana po shkon në plazh me gjyshen dhe babain. Dita është kaq e nxehtë dhe dielli djeg kaq shumë, saqë Albanës po i hahet shumë një akullore nga ato të mëdhatë me çokolatë. Ajo ndalon para një ëmbëltoreje dhe i kërkon të atit para për akullore. Ai i jep 50 lekë duke e porositur të blejë tre akullore-nga një për secilin prej tyre. Albana mban monedhën në dorë, e shikon pak me dyshim dhe i kthehet të atit: “Kur një akullore kushton 20 lekë, për tre akullore mua më duhen eeeeeee sa lekë?”



PYETJE 1: SA BËJNË 20 LEKË HERË TRE?

Në këtë moment gjyshja hap kuletën e saj dhe i zgjat Albanës një 10-lekësh duke i thënë: “Për tre akullore të duhen 60 lekë që ty të bëhen bashkë me këtë dhjetëlekëshe që po të jap unë.”. Pas dy minutash Albana kthehet me tre akullore. Ndërkohë që të tre hanë akullore, Albana pyet të atin: “Babi i haje shumë akulloret ti kur ishe i vogël?” “Posi, vetëm se atëherë më duheshin shumë më pak lekë se tani për një të tillë.”

60 lekë =



“Pse o babi sa lekë bënte një akullore si kjo kur ishe ti 9 vjeç?”

“Këtë e mbaj mend mirë sepse bleja gjithnjë me paratë e vogla që më jepnin prindërit dhe gjyshërit. Një akullore e ngjashme me këtë që po ha ti tani,



kushtonte gjysmë leku ose 50 qindarka. Blinim një ose dy në javë, jo më shumë se na bëheshin bajamet” - thotë babai duke qeshur.

“Po tani pse bën kaq shumë lekë? Po ti o babi ku i gjeje gjysmëlekshat që paguaje akulloret? Tani nuk ka më. Pse s’ka më?”

“Shiko, atëhere çmimet ishin ndryshe. Në ato kohë me 1 lek mund të blije shumë gjëra: akullore, kokoshka, bileta cirku. Kurse tani edhe pse ka monedha 1-lekëshe, ato nuk kanë vlerën që kanë patur dikur. Kjo është arsyeja pse ti nuk i shikon shumë nëpër xhepa dhe dyqane.”

Albana duket e çuditur dhe bën ca llogari me vete. Pastaj ankohet: “Po unë tani pse nuk blej dot 20 akullore me 20 lekë? Do të ishte shumë mirë.”

PYETJE 2: ALBANA BËRI NJË GABIM NË LLOGARI . E GJENI DOT SE SA AKULLORE MUND TË BLINTE ALBANA SOT ME 20 LEKË NËSE AKULLORET DO TË KUSHTONIN 50 QINDARKA APO 0.5 LEKË OSE GJYSMË LEKU SECILA?

Babai i shpjegon Albanës: “Çmimet e shumë produkteve janë rritur me kalimin e viteve. Çmimi i një bilete kinemaje tani mund të kushtojë më shumë nga ç’ka kushtuar vitin e kaluar dhe po kështu ka ndodhur edhe me një televizor apo me një palë këpucë. Mua më kujtohet koha kur një bukë



kushtonte 3 lekë dhe një shishe qumësht kushtonte 2 lekë. Në gjuhën e shkollës dhe në atë të të rriturve kjo gjë quhet inflacion. Me fjalë të tjera, inflacioni është dukuria që shkaktohet nga rritja e çmimeve të shumë mallrave njëkohësisht. Kur unë isha sa ty kisha shumë më pak lekë nëpër duar dhe me ato lekë mund të blija 2 apo 3 akullore në javë.”

“Pse o babi, inflacioni e rriti çmimin e akullores nga gjysmë leku në 20 lekë?”

“Pikërisht, në qoftë se inflacioni është i lartë, ti nuk mund të blesh po aq shumë me paratë e tua të xhepit. Për shembull, nëse akulloret vitin tjetër kushtojnë 22 lekë, ti nuk mund të blesh më 3 akullore me 60 lekët që të dhamë ne sot. Inflacion do të thotë që paraja me çdo vit që kalon ka gjithnjë e më pak vlerë”.
“Po mirë o babi, ti mund të më japësh mua më shumë para vitin tjetër, dhe më shumë pas dy vjetësh dhe kështu me rradhë.”

Babai mendohet pak dhe përgjigjet: “Shiko se kjo gjë nuk është aq e lehtë. Së pari, unë duhet të bie dakord që të të jap më shumë para të vogla për akullore dhe së dyti, duhet që puna ime të më paguajë mua më shumë para për të përballuar çmimet që rriten.”.

“Po kjo është e padrejtë!” hidhet Albana “Në qoftë se çmimet vazhdojnë të rriten dhe unë marr të njëjtën sasi parash, unë asnjëherë nuk do të kursej dot aq sa më duhen për të blerë atë biçikletën e bukur. Si t’ia bëj unë o babi?”.

“Mos u mërzit Albana, edhe nëse çmimi rritet pak, unë do të të ndihmoj ta blesh biçikletën. Po mos harro premtimin që më ke dhënë: dëftesa jote duhet të ketë vetëm 10-a këtë vit.”



Albana qetësohet. Dëftesa me 10-a nuk i duket ndonjë gjë shumë e vështirë. Biçikleta është aq e bukur sa ia vlen të mundohet për të.

ÇFARË ËSHTË INFLACIONI?

Inflacioni do të thotë që paraja ka gjithnjë e më pak vlerë me çdo vit që kalon. Monedhat e para të printuara nga Banka e Shtetit Shqiptar i përkasin pikërisht vitit 1947. Ato dolën në prerjet $\frac{1}{2}$, 1, 2 dhe 5 Lekë. Në vitin 1996 dhe më pas në vitin 2000, u emetua seria e monedhave dhe e kartëmonedhave që përdorim sot. Banka e Shqipërisë është autoriteti që emeton të gjitha monedhat dhe kartëmonedhat që përdoren në Shqipëri. Emrin e Bankës ju mund ta shikoni në çdo monedhë dhe kartëmonedhë që ju bie në dorë. Prej inflacionit 1 lek sot blen shumë më pak nga ç'ka blerë 30, 20 apo 10 vjet më parë. Duke qenë se inflacioni është i dëmshëm për ekonominë, Banka e Shqipërisë ka vendosur si qëllimin e saj kryesor mbajtjen e inflacionit në nivele të ulëta. Nëse Banka e Shqipërisë ia arrin këtij qëllimi, ju do të jeni në gjendje që edhe në të ardhmen të blini po aq mallra sa ç'jeni në gjendje të bleni tani. Kjo do të thotë që mundësitë për kursime në të ardhmen nuk do të ndryshojnë.





Botuar nga : Banka e Shqipërisë, Sheshi "Skënderbej", Nr.1, Tiranë.

Tel : 355-4-222230; 235568; 235569.

Faks : 355-4-223558.

e-mail: public@bankofalbania.org

[http:// www.bankofalbania.org](http://www.bankofalbania.org)

Shtypur në Shtypshkronjën e Bankës së Shqipërisë.

Tirazhi : 1000 kopje.